

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Data: 12.10.2015

Për: Shoqërinë “Fusha” sh.p.k. me NIPT J61922018S

Procedura e prokurimit: Procedurë e Hapur me objekt “Ndërtimi i shëtitores së Himarës”.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Ndërtimi i shëtitores së Himarës”.

Kohëzgjatja: Periudha e zbatimit të projektit do të jetë 9 muaj, periudha e mirëmbajtjes 12 muaj.

Fondi limit: 217.996.613 (dyqind e shtatëmbëdhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e trembëdhjetë) Lekë (pa TVSH).

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: Datë 18.09.2015.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Nuk ka patur.

Njoftojmë se kanë marrë pjesë në këtë procedurë:

Nr.	Operatori Ekonomik	Vlera (pa TVSH)
1	Elkri & Co	145,483,359

2	Gjiguria	171,498,232
3	Fusha	194,068,814
4	Çaushi/M	Nuk ka paraqitur ofertë
5	Elira	Nuk ka paraqitur ofertë
6	Kajmaku	Nuk ka paraqitur ofertë
7	Rosi	Nuk ka paraqitur ofertë

Janë skualifikuar operatorët e mëposhtëm ekonomike me arsyet përkatëse:

Bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Elkri” sh.p.k. (49%), “Tea” sh.p.k. (41%) dhe “A.E.K & Co” sh.p.k. (10%) për arsye se:

Shoqëria “Elkri” sh.p.k. nuk plotëson kërkesën 2.3.1 të kërkesave për kualifikim, pasi nuk plotëson kërkesën për xhiron mesatare të realizuar në tre vitet e fundit.

Xhiro mesatare e realizuar nga shoqëria është 84,812,819 Lekë, ndërkohë që sipas përqindjes së punëve që ka marrë përsipër duhet të kishte realizuar një xhiro jo më të vogël se 106,818,340 Lekë.

Shoqëria “Elkri” sh.p.k. nuk plotëson kërkesën 2.3.2 të kërkesave për kualifikim, pasi nuk ka paraqitur kopje të bilanceve të tre viteve të fundit, të paraqitur pranë autoritetit përkatës, të konfirmuara me shkresë të veçantë nga ky autoritet si dhe të shoqëruara nga akt ekspertiza e kryer nga Eksperti kontabël i autorizuar.

Shoqëria “Elkri” sh.p.k. nuk plotëson kërkesën për disponimin e stafit pasi nuk ka paraqitur diplomën për arkitektin, nuk ka paraqitur çertifikatën nga Ministria e Mjedisit për inxhinierin e mjedisit si dhe nuk ka paraqitur çertifikatën nga Ministria e Mjedisit për agronomin. Ndërkohe, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit, kjo shoqëri ka marrë përsipër të kryejë punimet e gjelbërimit.

Shoqëria “Elkri” sh.p.k. nuk plotëson kërkesën për disponimin e pikës së liçencës N.P – 8. “Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë”, ndërkohë që ka marrë përsipër të kryejë punime të tilla.

Shoqëria “A.E.K & Co” sh.p.k. nuk plotëson kërkesën për realizimin e punëve të ngjashme, pasi nuk ka paraqitur faturat tatimore për objektet e deklaruar.

Shoqëria “A.E.K & Co” sh.p.k. nuk plotëson kërkesën për disponimin e stafit pasi nuk ka paraqitur diplomat dhe librezat e punës për stafin e deklaruar.

Shoqëria “A.E.K & Co” sh.p.k. nuk plotëson kushtin 2.4.13 të kërkesave për kualifikim pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion se ka në stafin e tij, të siguruar sipas legjislacionit në fuqi, mjekun e shoqërisë të pajisur me liçencë të vlefshme dhe me kontratë pune të vlefshme. Kjo shoqëri ka më shumë se 15 punonjës dhe në përputhje me kërkesën, duhet ta kishte paraqitur këtë dokumentacion.

Shoqëria “Tea - D” sh.p.k. nuk plotëson kërkesën për realizimin e punëve të ngjashme, pasi nuk ka paraqitur faturat tatimore për objektet e deklaruar.

Shoqëria “Tea - D” sh.p.k. nuk plotëson kushtin 2.4.13 të kërkesave për kualifikim pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion se ka në stafin e tij, të siguruar sipas legjislacionit në fuqi, mjekun e shoqërisë të pajisur me licencë të vlefshme dhe me kontratë punë të vlefshme. Kjo shoqëri ka më shumë se 15 punonjës dhe në përputhje me kërkesën, duhet ta kishte paraqitur këtë dokumentacion.

Bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Gjiguria” sh.p.k, (85%), “Arti” sh.p.k, (6%), “R&T” sh.p.k, (5%) dhe “Kaleshi” sh.p.k, (4%) për arsye se:

Shoqëria “Gjiguria” sh.p.k. nuk plotëson kërkesën për disponimin e stafit pasi nuk ka inxhinier mjedisi, profili trajtim ujrash në stafin e vet. Dokumentacioni i paraqitur për zotin Gjig Shkurti nuk është i mjaftueshëm për të provuar plotësimin e kushtit, pasi ai është i diplomuar në biokimi. Shoqëritë e tjera të bashkimit të përkohshëm të shoqërive nuk kanë paraqitur asnjë dokumentacion për këtë inxhinier.

Shoqëria “Gjiguria” sh.p.k. nuk plotëson kërkesën për disponimin e stafit pasi nuk ka inxhinier agronom në stafin e vet. Dokumentacioni i paraqitur për zotin Lavdosh Feruni nuk është i mjaftueshëm për të provuar plotësimin e kushtit, pasi ai është i diplomuar në ekonomi agrare. Shoqërite e tjera të bashkimit të përkohshëm të shoqërive nuk kanë paraqitur asnjë dokumentacion për agronomin.

Shoqëria “Arti” sh.p.k. nuk plotëson kushtin për disponimin e stafit, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për stafin e kërkuar. Për rrjedhojë, shoqëria “Arti” sh.p.k. nuk plotëson edhe kushtin 2.4.8 të kërkesave për kualifikim pasi nuk ka paraqitur një deklaratë nga administratori i shoqërisë së inxhinierët e deklaruar në kërkesën 2.4.3 për kualifikim janë të disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate dhe nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

Shoqëria “Arti” sh.p.k. nuk plotëson kushtin 2.4.13 të kërkesave për kualifikim pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion se ka në stafin e tij, të siguruar sipas legjislacionit në fuqi, mjekun e shoqërisë të pajisur me licencë të vlefshme dhe me kontrate pune të vlefshme. Kjo shoqëri ka më shumë se 15 punonjës dhe në përputhje me kërkesën, duhet ta kishte paraqitur këtë dokumentacion.

Shoqëria “R&T” sh.p.k. nuk plotëson kushtin për disponimin e stafit, pasi me përjashtim të dokumentacionit të paraqitur për një arkitekt, nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion tjetër për stafin e kërkuar. Për rrjedhojë, shoqëria “R & T” sh.p.k. nuk plotëson edhe kushtin 2.4.8 të kërkesave për kualifikim pasi nuk ka paraqitur një deklaratë nga administratori i shoqërisë së inxhinierit të deklaruar në kërkesën 2.4.3 për kualifikim janë të disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate dhe nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

Shoqëria “R&T” sh.p.k. nuk plotëson kushtin 2.4.13 të kërkesave për kualifikim pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion se ka në stafin e tij, të siguruar sipas legjislacionit në fuqi, mjekun e shoqërisë të pajisur me licencë të vlefshme dhe me kontratë pune të vlefshme. Kjo shoqëri ka më shumë se 15 punonjës dhe në përputhje me kërkesën, duhet ta kishte paraqitur këtë dokumentacion.

Shoqëria “Kaleshi” shpk nuk ploteson kushtin per realizimin e puneve te ngjashme, pasi nuk ka paraqitur asnje dokumentacion per te vertetuar plotesimin e ketij kushti.

Shoqëria “Kaleshi” sh.p.k nuk plotëson kushtin për disponimin e stafit, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për stafin e kërkuar. Për rrjedhojë, shoqëria “Kaleshi” sh.p.k nuk plotëson edhe kushtin 2.4.8 të kërkesave për kualifikim pasi nuk ka paraqitur një deklaratë nga administratori i shoqërisë se inxhinierët e deklaruar në kërkesën 2.4.3 për kualifikim janë të disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate dhe nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera.

Shoqëria “Gjikuria” sh.p.k ka marrë përsipër të kryeje punime gjelbërimi në masën 18.718.071 Lekë (pa TVSH), ndërkohë që nuk ka në stafin e vet një agronom, si dhe nuk disponon liçencë për “Shërbim ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me pyjet dhe /ose kullotat” të lëshuar nga QKL, liçencë lidhur me ndikimin në mjedis të lëshuar nga QKL, liçencë për “Prodhimin dhe/ose tregtimin e farnave dhe/ose fidaneve” lëshuar nga QKL ose nje kontrate me nje subjekt të liçencuar për furnizimin e fidaneve si dhe nuk disponon certifikatë ISO 9001:2008 për prodhim drurë dekorative.

Shoqëria “Kaleshi” sh.p.k. ka marrë përsipër të kryejë punime gjelbërimi në masën 6.859.929 Lekë (pa TVSH), ndërkohë që nuk disponon liçencë N.P – 12 “Punime të inxhinierisë së mjedisit”.

Shoqëria “Caushi/M” sh.p.k. për arsye se nuk ka paraqitur ofertë.

Shoqëria “Elira” sh.p.k për arsye se nuk ka paraqitur ofertë.

Shoqëria “Kajmaku” sh.p.k për arsye se nuk ka paraqitur ofertë.

Shoqëria “Rosi” sh.p.k për arsye se nuk ka paraqitur ofertë.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqërinë “Fusha” sh.p.k. me NIPT J61922018S, se oferta e paraqitur, me vlerë 194.068.814 (njëqind e nëntëdhjetë e katër milion e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e katërmëdhjetë) Lekë (pa TVSH), është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit

vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **22.09.2015**.

Ankesa: Për vlerësimin paraqiti ankesë shoqëria “Elkri” sh.p.k, në datën 28 Shtator 2015. Ankimit iu dha përgjigje në datën 30.09.2015 duke e refuzuar atë.

